

LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE NË KOSOVË 1990-1992

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË HISTORI E KOHËS SË RE

NGA

ARBENITA ZOGIANI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

QERSHOR, 2021

EKSPOZE E TEMËS

LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE NË KOSOVË 1990-1992

Mentor:

Prof. Dr. Selim Bezeraj

Kandidatja:

Arbenita Zogiani

Periodha e viteve të '90 ishte periudhë me aq shumë ngjarje të cilat rrjedhnin njëra pas tjetrës dhe secila nga to me një rëndësi të veçantë, sa ato do të mjaftonin edhe për një shekull të tërë, e që do të ishin shkas që të shpinin deri te çlirimi i vendit dhe pavarësimi i saj. Pas grevës së minatorëve të shkurtit 1989, të cilat do rrjedhin deri te mësimi paralel, demonstratat dhe ngjarja më humane e më unifikuese e shqiptarëve, Pajtimi i Gjaqeve. Pajtimi i Gjaqeve hap një dekadë të re në fillim të vitit 1990 ku fillon unifikimi i shqiptarëve, gjë që në këtë kohë sikurse edhe në periudhat e tjera është shumë e rëndësishme, sepse “ti” nuk mund të luftosh armiqtë pa u bashkuar me miq. Ndoshta kjo Lëvizje ka bashkuar e pajtuar shumë shqiptarë, mirëpo kjo nuk nënkupton që është shthuru gjakmarrja, ajo vazhdon edhe sot e tutje, ani pse kemi gjykatat që punojnë në këtë drejtim ende mund të dëgjojmë në mjete informimi se sot ose dje është pajtuar kjo ose ajo familje.

Ndoshta shumë shpesh në tekstet shkollore edhe anashkalohet kjo ngjarje, mirëpo unë mendoj se ka arsye të fuqishme trajtimi i saj, në suaza të një të vërtet të cilën nuk mund ta anashkalojmë, por as ta mbi lartësojmë ose glorifikojmë. Sa herë që përmendet Lëvizja e Pajtitimit të Gjaqeve natyrisht që gjithsecili do përmend Anton Çettën, si figura më e ndritur e asaj periudhe. Krahas Anton Çettës nuk duhet të lënë anash as edhe personazhet që filluan dhe ideuan këtë Lëvizje, e cila më vonë edhe do të zgjerohet e do të marrin pjesë nxënës, studentë, arsimtarë, profesorë, akademikë dhe një numër i madh i aktivistëve vullnetarë.

Megjithëse kanë kaluar vetëm 30 vite dhe ende nuk janë botuar shënime të secilit sepse disa edhe kanë mbajtur ditarë, mirëpo një numër i konsiderueshëm i atyre që kanë marrë pjesë kanë botuar shkrimet e tyre, ose i kanë dërguar dikujt që t'i botojë ato në librat e tyre. Ditarë jo të gjithë kanë pasur guximin që t'i posedojnë dhe të mbajnë shënime sepse dihet ajo kohë ora policore dhe dhuna që bënin serbët ndaj shqiptarëve të Kosovës, mirëpo shumica çka kanë mbajtur janë shënime me vlerë dhe shpjegojnë gjithë ecurinë e punës, familjet që janë pajtuar, numrin e pjesëmarrësve, vendndodhjen etj.

Tema që kam zgjedhur për hulumtim në tezën për master, lirshëm mund të quhet një mikrotemë, pasi që i gjithë fokusi sillet rreth pajtimi të gjaqeve brenda dy viteve. Tema gjithashtu trajton edhe traditën shqiptare të përshkruar nga misionarët huaj e sidomos mbi gjakmarrjet dhe sanksionimin e saj në kanun. Pikë tjetër mjaftë interesante është edhe fakti se tema i takon periudhës para tri dekadash që do të thotë se ka edhe përjetues të atyre ditëve ende në mesin tonë, të cilët kanë qenë qoftë nismëtarë, bashkëpunëtorë, falës të gjakut të ndonjë familjari, e natyrisht që edhe intervistat me ta e bëjnë temë më atraktive dhe më hulumtuese.

Punimi përmban katër kapituj më të cilët është bërë pasqyrimi i temës prej idesë si filloi Lëvizja e deri te Kuvendi i fundi dhe përmbyllja e këtij takimi.

Kapitulli I trajton gjakmarrjen dhe sanksionimin e saj në kanun. Çfarë roli propagandon kanuni mbi gjakmarrjen dhe si kuptohet ajo prej masës së gjerë të popullsisë, e që shpesh edhe është keqkuptuar sepse nuk ka qenë i shkruar deri vonë, e vetëm është bartur brez pas brezi për një kohë të gjatë. Edhe pas kodifikimit të kanuneve nga legjislatorë ato nuk kanë mundur të mbërrijnë te masat e gjëra të popullsisë, vetëm janë kuptuar ose keqkuptuar nga etërit e tyre. Distanca nga qyteti ka bërë që të mos kenë një kanun në dorë, sepse nuk kanë arritur as kanunamet e sulltanit. Më pas kemi edhe rrethanat politiko shoqërore që sollën deri te fillimi i Lëvizjes.

Kapitulli II shënon fillimin e pjesës qendrore të temës, pasi që në të janë paraqitur ato celulat e para të fillimit të Lëvizjes, ideatorët dhe bashkëpunëtorët e parë. Janë paraqitur idetë se kur do të fillonte dhe ku Lëvizja, arritja e pajtimeve të para. Formimi i Këshillave të Pajtitimit nëpër qytete të ndryshme të Kosovës. Kuvendi i Verrave të Llukës i cili u mbajt me 1 maj 1990 ku morën pjesë rreth gjysmë milioni shqiptarë. Si dhe dy kuvendet e tjera të po atij viti, që ishin mbajtur për t'i vënë qëllimin dhe vazhdimin e punës me intensitet të deri më tanishëm.

Kapitulli III trajton rolin dhe rëndësin e figurave më të ndritura të cilat ishin edhe protagonistët kryesorë të Lëvizjes si dhe kontributin e tyre. Më pas plakun e mençur dhe të urtë që e quanin të gjithë dhe kontributin e tij që i dha kësaj Lëvizje, e që profesor Anton cilësohet si vet jeta e kësaj lëvizje. Rolin e rinisë dhe kontributin e tyre, e që natyrisht ishin vet nismëtarët shtylla kryesore dhe palodhshme e lëvizjes. Pa lënë anash si në çdo periudhë tjetër të historisë edhe rolin e klerit mysliman e katolik, e si çdo herë toleranca ishte mbizotëruese dhe klerikët ishin figurat kyçe që ndikon në zbutjen e zemrës dhe ndryshimin e mendimit të shumica e njerëzve. Krejt në fund të kapitullit të tretë kemi edhe rolin e gruas shqiptare, që ishte i pa krahasueshëm, sepse ato

luanin rol të madh në familje dhe në shoqëri e shumë shpesh përveç që ishin nismëtare, bashkëpunëtorë ato falën edhe gjakun e më të dashurve të tyre.

Në kapitullin IV dhe të fundit Mbresa dhe Përjetime kam paraqitur shkrimet e misionarëve të huaj nëpër kohë të ndryshme që kanë shkuar për gjakmarrjen dhe shqiptarët, si dhe disa që kanë shkruar për aktin e pajtimit të gjaqeve. Rrëfimet e studentëve që ishin pjesëmarrës dhe kishin rol të veçantë në lëvizje ku kanë shprehur mbresat e tyre dhe rastet më të veçanta që kujtojnë. Mendimet e intelektualëve rreth Lëvizjes për Pajtimin e Gjaqeve, përjetimet dhe mbresat e tyre për ngjarjen e cila njihet si Moti i madh në Kosovë. Punimi përfundon me intervistat me njerëz që kanë falur gjaqe ose që i është falur gjaku, intervista këto që janë marrë në teren edhe pse në kushte pandemie.

Studimi mbështetet në metoda shkencore, në thelb qëndron hulumtimi dhe përshkrimi i ngjarjeve, e pa lënë anash edhe studimin e thelluar mbi Lëvizjen dhe intervistat në terren me familjarët e familjeve të hasmëruara si dhe me protagonistët e ngjarjes.

Qëllimi kryesor i Lëvizjes për Pajtimin e Gjaqeve ishte unifikimi i shqiptarëve sikurse ishte bërë në çdo periudhë tjetër të historisë duke filluar nga koha e Skënderbeut i cili bënë bashkë princat shqiptarë në luftë kundër Perandorisë Osmane, më pas Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Lidhja e Pejës, Besëlidhja Popullore Shqiptare e Kosovës, Mbrojta kombëtare e Shqipërisë etnike gjatë 1941-1944, dhe me shembullin më të ri Grevën e Minatorëve gjatë vitit 1989. Kjo lëvizje përpos aspektit human kishte edhe karakter ushtarak e politik.

Fare në fund, dua të falënderoj Mentorin tim, Prof. Dr. Selim Bezeraj, për udhëzimet dhe lirinë akademike që më ka ofruar në punimin e kësaj teze të masterit.